



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FIER  
NJESIA E PROKURIMIT

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Fier, më \_\_\_\_ / 10/ 2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT: “Ndertim Depos se Uji V=200m3, Mbrostar Ura, Bashkia Fier”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Punime ndërtimi për depozita të ngritura uji 45232154-6

**VLERA E FONDIT LIMIT: 4 743 282.50 (kater milion e shtateqind e dyzet e tre mijë e dyqind e tetëdhjetë e dy pike pesëdhjetë) lekë pa TVSH**

Objekti do të prokurohet, kontraktohet dhe zbatohet me vlerë të plotë brenda grafikut të punimeve, por financimi do të bëhet në 2 (dy) vite buxhetore (2024, 2025), përkatësisht në shumat 4 868 539 lekë me TVSH për vitin 2024 dhe diferenca do të financohet për vitin 2025, bazuar në shkresën nr.10443/2 prot., datë 14.10.2024 të Drejtorisë Financë Buxhetit dhe Kontabilitetit.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Fier ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos bazuar ne nenin 76 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik“ i ndryshuar, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, ne te cilen eshte e percaktuar se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83 te Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilen eshte e parashikuar se:

*Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*

*Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:*

*a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;*

*b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar.*

*përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”*

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Sipas percaktimeve të bëra në Shtojcën 7 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (**2022, 2023**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo me pak se **1 600 000 leke pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te ligjit nr. 162/2020 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, ne te cilin gjejmë te percaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; ne piken 1 dhe piken 2/c te nenit 43 te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik"i ndryshuar, ku percaktohet se: **Pika 1.** *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.* **Pika 2/c:** *2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% te vlerës se parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nen kufirin e ulët monetar;**

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kerkuara, se zoterojne kapacitet ekonomik dhe financiar për të permbushur me sukses kontraten sic është parashikuar nga AK. Kriteri i mesiperm është ne perpjestim dhe i lidhur ngushte me objektin e kontrates.

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Pika 1 dhe pika 2/c e nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur e thjeshtuar, perkatesisht; Pika 2/c: *2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% te vlerës se parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nen kufirin e ulët monetar;* Duke qene se kjo procedure prokurimi është bazuar ne vleren e fondit limit nen kufirin e ulët monetar, AK duke u bazuar ne eksperiencen e suksesshme te procedurave te zhvilluara me pare gjykon se është e pershtatshme vendosja e kriterit te marzheve maksimale të percaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

---

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për*

Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; Njesia e prokurimit ka gjykuar te nevojshme percaktimin e dy viteve te fundit ne perputhje me vleren e fondit limit te parashikuar.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

### **2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:**

#### **Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:**

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Ne kete rast vlere e kerkuar eshte jo me pak se **800 000 lekë pa TVSH** (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 30% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet), që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

#### **ose**

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlere monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit eshte jo me pak se **4 000 000 leke pa tvsh** (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se vlere limit e kontratës që prokurohet).

#### **Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.**

#### **Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:**

- i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlere, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:
  1. Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me;
  2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
  3. Situacionin përfundimtar të objektit;
  4. Aktin e kolaudimit;

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

- ii) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:
  1. Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me;
  2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
  3. Situacionin përfundimtar të objektit;

4. Aktin e kolaudimit;
5. Fatura tatimore përfundimtare.

*Ne rastin e paraqitjes se ofertave nga bashkimi i operatoreve, pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.*

*Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”i ndryshuar).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë jo me pak se **800 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 30% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet) për një objekt të vetëm, ose jo me pak se **4 000 000 leke pa tvsh** (e cila është një vlerë jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet) për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

---

Autoriteti Kontraktor kerkon kontrate te ngjashme ne vlere jo me shume se 30 % te vleres se fondit limit, pasi vlera e parashikuar e kontratës është nen kufirin e ulët monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme si dhe referuar metodave të përforcimit të objekteve sipas projektit zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

### **2.3.2 Staf i kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet, i kualifikuar per keto punime.**

**a)** Operatori/ët ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë, inxhinierët e mëposhtëm:

1. Inxhinier Ndërtimi (si drejtues teknik) 1 (një);

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën periudhën **Shtator 2024**. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, kontratë individuale punë (*e vlefshme*).

**b)** Operatori/ët ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **ose** me kontratë pune të vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës specialistë ndërtimi të çertifikuar sipas profesioneve, të paktën si më poshtë:

- |  |         |
|--|---------|
| 1. Inxhinier Hidroteknik                               | 1 (një) |
| 2. Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder/ Gjeomatik | 1 (një) |

Për punonjësin e sipërcituar duhet të paraqitet: Diploma, Kontratë pune (e vlefshme).

**c)** Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij **ose** me kontratë pune të vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës 1 (një) përgjegjes për sigurinë dhe shëndetin në punë, i cili të jetë i çertifikuar me certifikatë/dëshmi si: **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”**, në përputhje me klauzolat e ligjit nr.10 237 date 18.02.2010 *“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”* dhe V.K.M nr.312, date 05.05.2010 *“Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”*.

Për punonjësin e sipërcituar duhet të paraqitet: certifikatë/dëshmi, Kontratë pune (e vlefshme).

**d)** Operatori/ët ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij (në listëpagesë) **ose** me kontratë pune të vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës specialist të çertifikuar sipas profesioneve të paktën si më poshtë :

- |                             |   |
|-----------------------------|---|
| ➤ Karpentier                | 2(dy),(në listë pagesë ose me kontratë pune)    |
| ➤ Hidraulik                 | 2(dy),(në listë pagesë ose me kontratë pune)    |
| ➤ Hekurkthyes               | 2(dy),(në listë pagesë ose me kontratë pune)    |
| ➤ Saldator                  | 1 (nje), (në listë pagesë ose me kontratë pune) |
| ➤ Eskavatorist              | 1 (nje), (në listë pagesë ose me kontratë pune) |
| ➤ Automakinist              | 1 (nje), (në listë pagesë ose me kontratë pune) |
| ➤ Shofer me leje drejtimi C | 2 (dy), (në listë pagesë ose me kontratë pune)  |
| ➤ Buldozerist               | 1 (nje), (në listë pagesë ose me kontratë pune) |

Për specialistët e sipërcituar sipas profesioneve, duhet të paraqiten , dëshmitë / çertifikatat ose çdo dokument tjetër që vërteton diplomimin apo kualifikimin e tyre sipas profesionit, si dhe kontratat individuale të punës të vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar të zbatimit të punimeve.

**Shënim:** Për pikat **a), b), c)** dhe **d)** me sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në shkronjat **a), b), c)** dhe **d)** të pikes **2.3.2**, si më sipër kërkuar. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c) të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, në K.Punës, legjislacionin për sigurimet shoqerore (pushimet, leje e zakonshme), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

**Konkretisht:** Vendosija e ketij kriteri per fuqine punetore eshte bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve dhe me mjetet e kerkuara per zbatimin me sukses te kesaj kontrate si dhe ne VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve”, sipas portalit SIM në e-albania si dhe bazuar ne Kodin e Punes se Republikes se Shqiperise me ligjin nr 7961 dt. 12.07.1995( i ndryshuar me ligjin nr. 9125 date 29.07.2003 dhe ndryshuar me ligjin 10053 dt. 29.12.2008)

Stafi i inxhinierëve të licencuar bazohet në Vendimin nr.759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” i ndryshuar.

**2.3.3** Operatori/ët Ekonomik duhet te ketë fuqi minimale punetore te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit, me nje numer prej jo me pak se **47 punonjës**, për **muajin Shtator 2024** (pa perfshire ne kete numer specialistet e certifikuar): Karpentier 2 (dy), Hidraulik 2 (dy), Hekurkthyes 2(dy), Saldator 1(nje), Eskavatorist 1 (nje), Automakinist 1(nje), Shofer me leje drejtimi C 2 (dy), Buldozerist 1 (nje), Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder/ Gjeomatik 1 (një), Inxhinier Hidroteknik 1 (një).

**Shënim:** Për pikën **2.3.3** më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën **2.3.3**, duke dorezuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve, për **muajin Shtator 2024.**
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për **muajin Shtator 2024.**

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”, në Kodin e Punës, legjislacionin për sigurimet shoqërore (pushimet, leje e zakonshme), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë tregojnë besueshmëri për autoritetin. Vendosja e kriterit për numrin e punonjësve duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t’i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përlllogaritja e fuqisë punëtore është bërë bazuar në - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve”, sipas portalit SIM në e-albania bazuar në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë me ligjin nr 7961 dt. 12.07.1995 i ndryshuar me ligjin nr. 9125 date 29.07.2003 si dhe me ligjin 10053 dt. 29.12.2008, bazuar në preventivat dhe grafikonin e punimeve 5 javore.

Është kërkuar paraqitja e listepageses së muajit **Shtator 2024** për arsye se është muaji i fundit i maturuar duke u nisur nga afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave. Bazuar në ligjin nr.9136 date 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (Neni 11 Afatet e deklarimit dhe të pagesës), operatorët ekonomikë kane afat të shlyejnë detyrimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore brenda datës 20 të muajit pasardhës.

### **2.3.4 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.**

Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se disponon liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e



rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar.

● **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë licensat e mëposhtme:**

1. NP - 1 A (Punime gjurmimi në tokë).
2. NP - 7 A (Ujësjetlësia, gazsjetlësia, vepra kullimi e vaditje).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar.

Pikat e licensës së firmës/ave janë nxjerrë bazuar në VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar dhe preventivit të punimeve.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, sipas preventivit bashkëngjitur në SPE.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
NP - 1 A	Punime gjurmimi në tokë	Analiza 3.87/a, 3.70/a, 2.15	A
NP – 7 A	Ujësjetlësia, gazsjetlësia, vepra kullimi e vaditje	depo në vetevetë së bashku me zërat e vendosjes së tubacioneve, analiza 2.231, 4.123/4, 2.552	A

**2.3.5 Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion:**

**a) Mjetet, makineritë dhe pajisjet teknike (pronesi ose me qera), te nevojshme per ekzekutimin e kontrates, si me poshte (sipas formularit permbledhes te vetedeklarimit, sipas shtojcës nr.8):**

NR.	EMËRTIMI I MAKINERISË DHE PAJISJES	SASIA	MANOVRATOR /SHOFER	STATUSI
1	Ekskavator 0.25 m3	1	ekskavatorist	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi
2	Kompresor	1	-	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi
3	Gazogjen	1	-	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi
4	Betonjere 500 liter	1	-	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi
6	saldatrice	1	-	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi
8	Rul (kompresor) me vibrim	1	Buldozerist	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi
9	Grejder	1	Buldozerist	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi
10	Autovinç me kapacitet ngritës min. 1 ton	1	Automakinist	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi

11	Vibrator	1	-	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi
12	Vibrator thellesie	1	-	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi
13	Auto vetshkarkuese me kapacitet mbajtës min. 10 ton	2	Shofer me leje drejtimi C	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi

**b) Operatori/ët ekonomik ofertues duhet te kete në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion, mjete dhe pajisje te mbrojtjes ne pune te punetoreve dhe personelit (pronesi ose me qera), te nevojshme per ekzekutimin e kontrates si me poshte (sipas formularit permbledhes te vetedeklarimit, sipas shtojcës nr.8):**

- Kokore, minimumi 61 copë.
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila, minimumi 2 copë.
- Komplet i ndihmës së shpejtë, minimumi 2 copë.
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi, 4 copë.

**Shënim:** Për pikën 2.3.5 (a dhe b) si më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën sipas formularit përmbledhës të vetedeklarimit, sipas shtojcës nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetedeklarimet në formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sic kërkohet në pikën 2.3.5 (a dhe b), duke dorezuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin si më poshtë:

- a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit

**teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit.**

- b) Për mjetet e siguruar me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit, si dhe duhet të shoqërohet me kontraten perkatese noteriale të qerases, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.**
- c) Në rastin e mjeteve apo pajisjeve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.**
- d) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij/tyre.**
- e) Makinat e transportit te shoqerohen gjithashtu edhe me Leje te Transportit te Mallrave (te vlefshme), leshuar nga organet kompetente ne emer te shoqerise apo subjektit pronar te mjetit, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.**

**Argumentimi:**Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.Gjithashtu, kerkesat per disponimin ose mundësinë e sigurt te disponimit të mjeteve apo kapaciteteve teknike te kerkuara ne kete kerkese per kualifikim, bazohet edhe ne nevojen per mundesine e sigurte te disponimit te mjeteve qe AK kerkon nga OE, te cilet duhet te vërtetojnë se zotërojnë kualifikime te nevojshme teknike, kapacitetet organizative, makineritë, pajisje te aseteve të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, për të zbatuar kontratën, duke demonstruar kapacitet teknik si per mjetet qe do te angazhohen ne zbatimin e kontrates, ashtu edhe per kapacitet teknike qe lidhen me gadishmerine per plotesimin e tyre ne rrethana te caktuara, duke pasur si synim zbatimin e ne kohe dhe ne cilesi te kontrates objekt prokurimi. Përlllogaritja e makinerive është bërë bazuar në - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve”, sipas portalit SIM në e-albania. Emërtimi i manovratorve është bazuar në nenin 8 të Urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet, kriteret dhe programet për pregatitjen teorike- praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe tokë , si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit".

**Kerkesat per makinerite/mjetet qe nevojiten argumentohet ne baze te zerave te preventivit:**

**“Ndertim Depos se Uji V=200m3”, Mbrostar Ura, Fier**

<b>NR.</b>	<b>EMËRTIMI I MAKINERISË DHE PAJISJES</b>	<b>SASIA</b>	<b>MANOVRATOR /SHOFER</b>	<b>SHËNIME</b>	<b>STATUSI</b>
1	Ekskavator 0.25 m3	1	ekskavatorist	Zëri i preventivit me analizë 3.87/a	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi
2	Kompresor	1	-	Zëri i preventivit me analizë 3.70/a	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi
3	Gazogjen	1	-	Zëri i preventivit me analizë 2.181	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi
4	Betonjere 500 liter	1	-	Zëri i preventivit me analizë 3.240	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi
6	saldatrice	1	-	Zëri i preventivit me analizë 2.231, 4.123/4, 2.181	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi
8	Rul (kompresor) me vibrim	1	Buldozerist	Zëri i preventivit me analizë 3.212	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi
9	Grejder	1	Buldozerist	Zëri i preventivit me analizë 3.212,3.183/a	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi
10	Autovinç me kapacitet ngritës min. 1 ton	1	Automakinist	Zëri i preventivit me analizë 2.181, 2.166, 2.197, 2.262/3, 2.166/1a	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi

11	Vibrator	1	-	Zëri i preventivit me analizë 2,114, 2.587	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi
12	Vibrator thellesie	1	-	Zëri i preventivit me analizë 3.240	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi
13	Auto vetshkarkuese me kapacitet mbajtës min. 10 ton	2	Shofer me leje drejtimi C	Zëri i preventivit me analizë 2.37/1a, 3.183/a, 3.212, 2.231, 3.837, 2.552, 2.584/2, 2.576/2, 2.587, 2.166/1a	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi

Shënim: Emërtimi i manovratorve është bazuar në nenin 8 të Urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teorike- praktike të kandidatëve, si dhe dhenien e deshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe tokë , si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit" kurse makinerit janë nxjerr bazuar në VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve", sipas portalit SIM në e-albania. Në pamundësi të instalimit të vinçit kullë (per shkak te mos caktimit ne projekt te nje bazementi prane depove) është menduar që konkretisht zëri Vinc kulle 6-10 T, Vinç kullë 4-6 T me manovrator, autovinc deri ne 2.5 ton, elektroorgano si dhe vinc të zëvendësohet me autovinç me kapacitet ngritës min. 1 ton. Gjithashtu per thjeshtesim te procedures do te kerkohet vetem 1 saldatrice dhe jo elektrosaldatrice, saldatrice elektrike dhe motosaldatrice.

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e tërësisë së informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ofertues për këtë procedurë prokurimi, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.*

**Shënim:** Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të nenit 26 të VKM nr.285 datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuar me

originalin.(pika 6 e nenit 26 të V.K.M. nr.285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar).

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistët e fushës të Drejtorisë së Projekteve dhe të Infrastruktura dhe janë dërguar me shkresën me nr. 10443 prot., datë 14.10.2024 plotësuar me shresën me nr 10443/3 prot., date 15.10.2024 nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës, bashkëngjitur DST në SPE. Kriteret e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga specialisti i fushës pjesë e njësisë së prokurimit.*

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

### **Njësia e Prokurimit:**